



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 428/4 Prot.

Tiranë, më 10.06.2019

V E N D I M

Nr.75, Datë 10/06/2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONET NË VARËSI TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, QENDRA E
TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE, VLORË DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjitnr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar,tëligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar nëQendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 36, datë 17.04.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e

administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 873 prot., datë 03.12.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr.873/1 prot., datë 03.12.2018, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”, i është njoftuar subjektit fillimi i procesit.

Subjekti i mbikëqyrrur përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas lidhjes nr. 1, (me numër rendor 78), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrrur me shkresën nr.428, prot. datë 19.04.2019, të Komisionerit, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Selenicë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë afat 15 ditë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 125/1 prot., datë 05.05.2019, të Drejtorit të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, “Kthehet projekt raporti i firmosur pa observacione”, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar pa paraqitur observacione, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i mbikëqyrjes, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratoj përbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të dërgojë formularët e përshkrimit të punës, pranë Departamentit të Administratës Publike, për të marrë edhe miratimin e njësisë përgjegjëse dhe më tej t'i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.
3. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të përcjellë kërkesën për nxjerrjen e aktit të krijimit të Komisionit të Ristrukturimit, sipas dispozitave të Kreut VIII, *“Transferimi në shërbimin civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim zbatimin e urdhrit të Kryeministrit nr. 66, datë 04.05.2015, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”*.
4. Departamenti i Administratës Publike të mbikëqyr realizimin e procesit të ristrukturimit në këtë institucion dhe të informojë Komisionerin në lidhje me veprimet e kryera.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
6. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive, Vlorë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA